



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:073755  
Datë: 13.03.2024  
Numri i dokumentit: 05445896

**Ac.nr.6356/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil** me gjyqtarin individual Adnan Konusheveci, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, SH.A., me seli në Prishtinë, Rruga “Bill Klinton”, kundër debitorit H.P, Komuna P., Rruga “S...”, p.n., për pagesën e borxhit në shumë prej 697.18 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.34/2022 i datës 23.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në P., me datë 13.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, SH.A., nga Prishtina, Rruga “Bill Klinton”, ndërsa aktvendimi PPP.nr.34/2022 datë 23.06.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në P., **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë -Dega në P., me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.34/2022 i datë 23.06.2022, ka vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të aktvendimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për caktimin e përmbarimit, P.nr.255/2022 datë 18.03.2022, të lejuar nga Përmbaruesit Privat Flamur S. Bogaj, në Prishtinë, për shumën 640.78 euro, të kërkesës së objektit të pambarimit. Në pikën -II-, të dispozitivit të aktvendimit të atakuar është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit, për sa i përket kërkesës së objektit të përmbarimit, në shumën prej 56.40 euro, dhe për këtë shumë urdhri mbi caktimin e përmbarimit, P.nr.255/2022, i datës 18.03.2022, ka mbetur në fuqi. Në pikën -III- të dispozitivit të aktvendimit të atakuar është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet aktvendimi i atakuar PPP.nr.34/2022 i datës 23.06.2022, ashtu që i njëjti të ndryshohet si dhe të aprovohet si i themelet urdhri për përmbarrim, të mbetet në fuqi.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore (LPP) si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarrim me datë 18.03.2022, ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm—ekstraktit të verifikuar nga librat e afarist, për pagesën e shërbimeve komunale ,për bartjen e mbeturinave nr.42838, për periudhën prej datës 30.06.2018 e deri me datën 28.02.2022, në shumën e detyrimit, prej 697.18 euro.

Përmbarruesi Privat, me urdhrin P.nr.255/2022 të datës 18.03.2022, e ka lejuar përmbarrimin. Debitori pas pranimit të urdhrin për përmbarrim ka paraqitur kundërshtim, me propozim që Gjykata, ta anuloj urdhrin për përmbarrim.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të kundërshtimit të debitorit, ka vendos si në dispozitiv të saj, duke e pranuar pjesërisht prapësimin dhe duke lënë jashtë fuqisë juridike urdhrin për përmbarrim, për sa i përket shumës së borxhit prej 640.78 euro.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Gjykata, ka theksuar se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pas shqyrtimeve të pretendimeve të debitorit në prapësim, ka gjetur se lejimi për përmbarrim është i pa bazuar, dhe i pa ligjshëm sepse kemi të bëjmë me parashkrim konform nenit 360 të LMD-së. Ndërsa lidhur me borxhin për periudhën tjetër ka gjetur se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka parashkrim të borxhit të kreditorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b),

g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, po ashtu nuk kemi shkelje as të dispozitave të procedurës përbarimore qoftë atyre procedurale po edhe materiale.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e pranuar pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit dhe duke lënë pjesërisht në fuqi urdhrin përbarimor, P.nr.255/2022 datë 18.03.2022, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se kreditori ka kërkuar propozimin për përbarim nga data 30.06.2018 deri me datën 28.02.2022. Gjykata e Apelit vlerëson se borxhi për periudhën nga data 30.06.2018 deri me datën 31.12.2020, është borxh i parashkruar sepse kërkesat për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë parashkruhen në afatin 1 vjeçar, ashtu siç përcaktohet me nenin 360 par.1, nën par. 1.1 i LMD-së përcakton se: *”Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*.

Gjykata ankimore e mbështet qëndrimin e Gjykatës së shkallës së parë lidhur me parashkrimin e borxhit për faktin se për këtë Gjykatë rezulton të provohet se kreditori ka parashtruar propozim për përbarim pranë Organit Përbarues me datë 18.03.2022. Pra, në rastin konkret është arritur afati i parashkrimit sepse kemi të bëjmë me pagesat për bartjen e mbeturinave, ndërsa nga koha kur e ka kërkuar kreditori borxhin e deri të paraqitja e propozimit për përbarim kanë kaluar më tepër se 1 vit, andaj me arritjen e afatit të parashkrimit pushon edhe e drejta e kreditorit që të kërkojë përmbushjen e detyrimit.

Nga ekstrakti i librave afarist vërehet se debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme, mirëpo këto pagesa në asnjë mënyrë nuk shkaktojnë ndërprerjen e parashkrimit sepse nga të njëjtat nuk mund të konstatohet se për cilën periudhë kohore është bërë pagesa e borxhit.

Neni 368 përcakton se: *“1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në këtë rast nuk është shkaktuar ndërprerja e parashkrimit sepse pagesat e kohë pas kohshme nuk mund të konsiderohen si pranim i borxhit, sepse nuk kemi deklaratë të kreditorit se e ka pranuar borxhin, po ashtu pagesat nuk janë bërë në emër të ndonjë kësti, andaj nuk kemi as ndërprerje të parashkrimit. Pra, me rastin e kalimit të afatit të caktuar me ligj për parashkrimin e këtyre natyrave të kërkesave është shuar edhe e drejta e kreditorit për të kërkuar përmbushjen e

detyrimit, ndërsa pas kësaj periudhe debitori ka për detyrim që të paguajë borxhin e mbetur në shumë prej 56.40 euro.

Pretendimi i kreditorit se është pranuar borxhi është i pa bazuar sepse në shkresat e lëndës për periudhën kontraktuese nuk është prezantuar asnjë provë shkresore për pranimin e borxhit nga ana e debitorit.

Kështu duke pasur për bazë shkresat e lëndës, kjo Gjykatë nuk e aprovon si të bazuar pretendimin se vendimi i gjykatë së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse kreditori me asnjë provë nuk ka arritur që ti bazojë pretendimet e veta në mënyrë që kjo Gjykatë të marrë vendim ndryshe nga ai si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6356/2022 datë 13.03.2024**

**Gjyqtari**  
Adnan Konushevci